



GJAKOVA



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2026

Dt.30.04.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, bazuar në nenin 12 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 , nenin 18.2 shkronja e të Statutit të Komunës së Gjakovës, dhe në nenin 5.2 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2026, pas diskutimeve lidhur më pikën e 6 të rendit të ditës: formimi i Komisionit Komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “Ngrohtorja e Qytetit” SH. A Gjakovë, e miratoi këtë :

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “ Ngrohtorja e Qytetit” SH. A Gjakovë, në këtë përbërje:

1. z. Xhavit Alijaj, i emëruar nga Kryetari i Komunës.
2. znj. Albulena Komani, përfaqësuese e Kuvendit .
3. z. Shkëmbin Rama, përfaqësues i Kuvendit

2. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

3. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komisionit.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Shefqet Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-18226
Dt: 20.04.2026


Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve, me datë 20.04.2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Xhavit Alijaj, emërohet anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A.
2. Ky vendimi i dërgohet Kuvendit të Komunës për të emëruar edhe dy anëtarë të tjerë nga radhët e Kuvendit, siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
- Anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës